

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5742
E mërkurë, 3 prill 2019
çmimi 0.40 €

Kurti me deputetë dhe veprimtarë politikë përkujtojnë demonstratat e '81-shit

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIPI HAVOLLI

FAQE 4-5

Gjendja nuk është e mirë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit

- Do të ketë zgjerim të kompetencave
dhe forcim të rolit të AKK-së në
luftimin e korrupsionit



Drejtori i Agjencisë Kundër
Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka
bërë me dije se procesi i deklarimit të
pasurisë së zyrtarëve publikë ka
shkuar mirë dhe verifikimit do t'i
nënshtrohet 20 për qind e listës së
përgjithshme. Ai nuk e ka përfunduar

mundësinë që ky numër të rritet në
rast të denoncimeve nën dyshimet për
deklarim të rremë. Në këtë intervistë
dhënë për gazetën "Epoka e re",
Havolli ka thënë se në Kosovë ekziston
një gjendje jo e mirë sa i përket paran-
dalimit dhe luftimit të korrupsionit,

sidomos të nivelit të lartë. Megjithatë,
ai ka treguar se mbi 100 raste për kor-
rupsion janë duke u trajtuar në AKK sa
i përket tremujorit të këtij viti. Havolli
ka paralajmëruar se do të ketë zgjerim
të kompetencave dhe forcim të rolit të
AKK-së në luftimin e korrupsionit



Kosova legalizon 246 armë

FAQE 3

Që nga fillimi i fushatës për legalizimin e armëve të lehta
janë marrë 630 kërkesa për legalizim të armëve, ndërsa janë
lëshuar 246 pëlqime. Kjo është bërë me dije të martën në
takimin koordinues për planin e veprimit të udhërrëfyesit
rreth armëve të vogla, armëve të lehta dhe eksplozivëve.
Edhe diplomatët e akredituar në Prishtinë janë shprehur të
kënaqur me dinamikën me të cilën është duke u punuar në
drejtim të zbatimit të këtij plani të veprimit

Bytyqi kërkon nga SBASHK-u reflektim për zëvendësimin e orëve të humbura

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

AFORIZMA PËR POLITIKANËT QË DËGJOJNË (III)

F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

PRESIDENTI THAÇI: EJUP RUNJEVA ISHTE MODEL I LUFTËTARIT TË LIRISË

F. 5

KOSOVA SHËNON DITËN BOTËRORE TË NDËRGJEGJËSIMIT TË AUTIZMIT

F. 6

MJEKËT NË KLINIKËN E ORTOPEDISË KRYEJNË ATROSKOPINË E PARË TË KRAHUT

F. 6

EKONOMI

BANKA BOTËRORE: RITJJA EKONOMIKE PRITET TË JETË 4.5 PËR QIND

F. 9

MINISTRI SHALA: KËNAQËSI KUR SHEH PRODHUESIT VENDORË QË JANË KONKURRUES PËR TREGJET E HUAJA

F. 9

SPORT

AHMETI: STADIUMI ËSHTË I PRISHTINËS, AS I QEVERISË E AS I FFK-së

F. 14

NATO-ja shënon 70-vjetorin mes tensionesh transatlantike

Presidenti Donald Trump e ka kritikuar aleancën, duke fajësuar vendet anëtare për mosinvestime në mbrojtje dhe duke u mbështetur shumë te Shtetet e Bashkuara. Vëzhguesit do të shohin nga afër se si aleanca do t'i përballojë stuhitë e brendshme në këtë përvjetor



WASHINGTON, 2 PRILL - Ministrat e jashtëm të NATO-s janë mbledhur në Uashington D. C. për ta festuar 70-vjetorin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior. Presidenti Donald Trump e ka kritikuar aleancën, duke fajësuar vendet anëtare për mosinvestime në mbrojtje dhe duke u mbështetur shumë te Shtetet e Bashkuara. Vëzhguesit do të shohin nga afër se si aleanca do t'i përballojë stuhitë e brendshme në këtë përvjetor.

Presidenti Trump, i cili priti sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, për bisedime në Shtëpinë e Bardhë të martën, i bëri të qarta pikëpamjet e tij për NATO-n gjatë fushatës presidenciale të vitit 2016, duke tronditur shumë në të dyja anët e Atlantikut kur e quajti aleancën "të vjetruar". Ai tha se ajo kishte humbur fokusin, ndërkohë që në mënyrë të përsëritur pretendoi se Shtetet e Bashkuara kishin mbajtur barrën më të madhe të kostos.

Shumica e ekspertëve të politikës së jashtme amerikane thonë se NATO-ja është një nga aleancat më të suksesshme ushtarake në histori dhe është larg të qenit e padobishme. "Aleanca ka shfaqur një aftësi për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve në të kaluarën, që nga rigjallërimi i Rusisë, te menaxhimi i krizës në jug të krahut të NATO-s, si dhe në trajtimin e çështjeve të sigurisë kibernetike. Kështu që NATO-ja po përshtatet dhe aleatët po shpenzojnë më shumë për mbrojtjen", tha për "Zërin e Amerikës", Mark Simakovsky, ekspert me Këshillin e Atlantikut.

Shpenzimet ushtarake kanë qenë një çështje thelbësore për presidentin Trump, i cili shpesh ka bërë presion ndaj aleatëve evropianë për t'i rritur shpenzimet e tyre të mbrojtjes. "Të gjithë kanë rënë dakord ta rrisin angazhimin e tyre në nivele që kurrë nuk është menduar më parë", u tha Trumpi gazetarëve gjatë një samiti të NATO-s vitin

e kaluar. Sipas udhëzimeve të NATO-s, shtetet anëtare duhet të shpenzojnë së paku dy për qind të bruto produktit vendor në ushtri çdo vit. Por vetëm shtatë nga 29 shtetet anëtare arritën këtë nivel në vitin 2018. Disa ekspertë mendojnë se rregulli i dypërqindëshit është shumë i rëndësishëm. "Nuk po ia jep këto fonde dikujt tjetër, nuk po i vendos ato në një buxhet të NATO-s diku, por po i shpenzon për vete", tha drejtori i Institutit McCain, Kurt Volker, i cili më parë ka shërbyer ambasador i ShBA-së në NATO.

"Ky është një demonstrim i angazhimit tuaj për sigurinë, që pastaj i jep NATO-s besimin se ky është një vend që ne mund ta ndihmojmë në mbrojtje, sepse janë të angazhuar për mbrojtjen e territorit të tyre", tha ai. Ekspertë të tjerë bien dakord se shpenzimet e mbrojtjes janë të rëndësishme, por thonë se aleanca ka në themel të vet aftësinë e anëtarëve për t'i besuar njëri-tjetrit dhe presidenti Trump e ka dëmtuar atë besim. "Kur një president amerikan vë në pikëpyetje vlerën e aleancës, armiq të tanë

në Moskë dhe në Pekin tani po pyesin nëse NATO-ja do t'u vinte në mbrojtje disa kombeve më të vogla që presidenti i ka kritikuar, ndoshta si jo të denja për t'u mbrojtur nga aleanca", tha Simakovsky. "Por unë nuk mendoj se në këtë samit administrata Trump do të njoftojë ndonjë largim të Shteteve të Bashkuara", tha ai.

Eksperti Simakovsky thotë se partnerët ranë dakord t'i ulnin takimet e Uashingtonit në nivel të ministrave të jashtëm për ta shmangur rrezikun e sulmeve verbale nga presidenti Trump.

Xhaferi pret kryeministrin grek Tsipras

SHKUP, 2 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, priti të martën në takim kryeministrin grek Aleksis Tsipras në kuadër të vizitës së këtij të fundit që po e zhvillon në vendin fqinj.

Xhaferi, duke e vlerësuar takimin si historik, i uroi të dy kryeministrat, atë të Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, për guximin dhe për hapat e ndërmarrë me të cilët u tejkalua kontesti me dekada ndërmjet të dy vendeve dhe në këtë mënyrë u hap rruga për integrimin euroatlantik të



Maqedonisë së Veriut, përcaktimi strategjik i shtetit dhe i shu-

micës së qytetarëve të saj. "Si parlament i mbështesim të

gjitha angazhimet për shndërrimin e bashkëpunimit kontraktues në projekte konkrete, që presim të marrin intensitet në të ardhmen", theksoi Xhaferi.

Ai shtoi se pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Prespës vendoset korniza juridike e cila do të mundësojë bashkëpunim parlamentar në të gjitha bazat dhe në këtë drejtim i informoi të pranishmit për ftesën e dërguar te homologu i tij Nikollaos Vucis që të realizojë vizitë bilaterale në Maqedoninë e Veriut, si dhe për kërkesën e dërguar te pala greke për formimin e grupit për miqësi

në Parlamentin e Greqisë me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tsipras, duke falënderuar për mbështetjen e dhënë, theksoi se në periudhën e kaluar u miratuan vendime të mëdha dhe u ndërmorën hapa të mëdhenj dhe, në këtë kontekst, i uroi kryekuvendarit Xhaferi për qetësimin në mbajtjen e procedurës institucionale në lidhje me Marrëveshjen e Prespës, që e vlerësoi si proces të vështirë edhe për Kuvendin e Maqedonisë së Veriut edhe për Parlamentin e Greqisë.

Reka: S'e pranojmë konceptin e kombit statistikor

SHKUP, 2 PRILL - Kandidati për president të Maqedonisë Veriore, Blerim Reka, i mbështetur nga Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja Besa, fushatën e filloi në Sheshin "Skënderbeu" në Shkup. Ai tha se shqiptarët e përcarë duhet paraprakisht ta arrijnë konsensusin me vëllain

para konsensusit me fqinjin. Reka tha se shqiptarët në këto zgjedhje duhet të dëshmojnë se nuk e pranojnë konceptin e kombit statistikor. "Me votën tuaj tregoni se ne nuk jemi 20 përqindëshi anonim siç na trajtojnë tash e 20 vjet. Dëshmoni se ju nuk e pranoi konceptin e

kombit statistikor. Tregoni se ju nuk jeni vetëm votues, por edhe të votuar. Sepse deri më tash shqiptari asnjëherë nuk u zgjodh president i këtij vendi. Ishim 100 për qind tatimpagues, por ende tash e 20 vjet na trajtojnë 20 për qind", tha Blerim Reka.



Është mbajtur takimi koordinues për planin e veprimit të udhërrëfyesit rreth armëve të vogla, armëve të lehta dhe eksplozivëve

Kosova legalizon 246 armë

Nga fillimi i fushatës për legalizimin e armeve të lehta janë marrë 630 kërkesa për legalizim të armëve, ndërsa janë lëshuar 246 pëlqime. Kjo është bërë me dije të martën në takimin koordinues për planin e veprimit të udhërrëfyesit rreth armëve të vogla, armëve të lehta dhe eksplozivëve. Edhe diplomatët e akredituar në Prishtinë janë shprehur të kënaqur me dinamikën me të cilën është duke u punuar në drejtim të zbatimit të këtij plani të veprimit

**EPOKA
ERE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 2 PRILL - Republika e Kosovës po zbaton në mënyrë të suksesshme fushatën e legalizimit të armëve të lehta. Kështu është thënë në takimin e parë për planin e veprimit të udhërrëfyesit rreth armëve të vogla, armëve të lehta dhe eksplozivëve, të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Në hapje të këtij takimi zëvendësministri i

Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka bërë me dije se 246 armë janë legalizuar nga 630 kërkesa sa janë bërë që kur ka nisur fushata për regjistrimin e armëve ilegale në dhjetor të vitit të kaluar. "Kosova po zbaton me sukses një fushatë legalizimi që filloi më 17 dhjetor 2018 dhe do të zgjasë deri më 17 qershor 2019. Që nga fillimi i fushatës janë marrë 630 kërkesa për legalizim të armëve, ndërsa janë lëshuar 246 pëlqime, 630 armë që ishin në posedim të

paligjshëm tani janë në kontroll", ka thënë Zeka. Ai ka theksuar se Kosova është e përkushtuar ta zbatojë udhërrëfyesin dhe planin e veprimit. "Ne po punojmë më tej për harmonizimin e ligjeve përkatëse dhe për harmonizimin e direktivave dhe rregulloreve të BE-së, për të cilat janë mbajtur punëtori për plotësim-ndryshimin e Ligjit për armët dhe Ligjit për legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve, municioneve dhe materialeve shpërthyes", ka thënë Zeka.

Zëvendësambasadorja e Francës, Carole Blestel, ka thënë se është e kënaqur me dinamikën me të cilën është duke u punuar në drejtim të zbatimit të këtij plani të veprimit. Ajo ka përgëzuar autoritetet e Kosovës për përkushtimin dhe dinamikën e treguar për zbatimin e planit të veprimit dhe ka bërë me dije se Kosova është

vendi i parë në rajon i cili ka adoptuar këtë plan të veprimit. Ndërsa zëvendësambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, Jan - Alex Voss, ka thënë se çështja e armëve të paligjshme është një temë serioze jo vetëm për Kosovën, por edhe për Gjermaninë, Francën dhe tërë Evropën. Ai ka thënë se interesi i përbashkët i të gjithëve është që sa më parë këto armë të jenë të kontrolluara nga ana e autoriteteve. Voss ka ofruar përkrahjen e plotë të Gjermanisë për implementimin e udhërrëfyesit dhe planit të veprimit.

Gjithashtu, ushtruesi i detyrës së Divizionit të Çështjeve Ligjore dhe Sundimit të Ligjit nga Zyra e BE-së, Hakan Ejderdik, ka pohuar se çështja e armëve ilegale është një temë shumë serioze sepse rrezikon drejtpërdrejt sigurinë e të gjithë qytetarëve. "Ne përballemi me

sfida të shumta, por jam i bindur që së bashku mund t'i luftojmë në mënyrë që ta ruajmë paqen në Evropë", ka thënë ai.

Udhërrëfyesi ofron zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) dhe municionin e tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024, ku u miratua në Samitin e Londrës më 10 korrik 2018. Udhërrëfyesi zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet relevante të rajonit, nën kujdesin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe përkrahjen teknike të SEESAC/UNDP dhe në koordinim me Mbretërinë e Bashkuar, Francën dhe Komisionin Evropian. Ndërsa plani i veprimit për zbatimin e udhërrëfyesit u miratua po nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor 2018.



Countryman: Rivendosja e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë nuk është zgjidhje e këtij shekulli

PRISHTINË, 2 PRILL - Ideja e ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë nuk është zgjidhje e shekullit 21. Kështu ka thënë, në një intervistë për "Radion Evropë e Lirë", ish-zëvendësndihmës sekretari amerikan i shtetit për çështje evropiane, Thomas

Countryman. Sipas tij, arritja e një marrëveshje midis dy vendeve duhet të merret nga liderët dhe qeveritë përkatëse dhe se ky nuk është një vendim ndaj të cilit Shtetet e Bashkuara kanë veto. Në këtë intervistë ish-përgjegjësi për Ballkanin në Departamentin e

Shtetit, tash drejtor i bordit të Asociacionit për Kontrollin e Armëve, Thomas Countryman, flet edhe për rrezikun që paraqesin disa liderë të Ballkanit për qytetarët e vendeve të tyre si dhe mundësinë e një konflikti të ri në rajon.

Flet për "Epokën e re", Shaip Havolli

Gjendja nuk është e mirë në parand

- Do të ketë zgjerim të kompetencave dhe forcim të rolit të AKK-së në luftimin e korrupsionit

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka bërë me dije se procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publikë ka shkuar mirë dhe verifikimit do t'i nënshtrohet 20 për qind e listës së përgjithshme. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që ky numër të rritet në rast të denoncimeve nën dyshimet për deklarim të rremë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Havolli ka thënë se në Kosovë ekziston një gjendje jo e mirë sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, sidomos të nivelit të lartë. Megjithatë, ai ka treguar se mbi 100 raste për korrupsion janë duke u trajtuar në AKK sa i përket tremujorit të këtij viti. Havolli ka paralajmëruar se do të ketë zgjerim të kompetencave dhe forcim të rolit të AKK-së në luftimin e korrupsionit



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 PRILL - Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka thënë të martën se në Kosovë ekziston një gjendje jo e mirë sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, sidomos të nivelit të lartë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se nuk i ka habitur as konstatimi i raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit se Kosova ka ngecur në luftimin e kësaj dukuri. "Sa i përket raportit të fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, lidhur me faktin se Kosova ka ngecur në aspekt të luftimit të korrupsionit, mund të them se nuk jemi të habitur nga ky fakt apo konstatim në këtë raport, pasi ekzistojnë mekanizma të shumtë që vlerësojnë shkallën

e korrupsionit në vendin tonë qoftë nga ne si agjenci, institucione të tjera publike, shoqëria civile dhe vlerësime të tjera nga jashtë duke konstatuar një gjendje jo të mirë sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, me theks të veçantë korrupsionin e nivelit të lartë dhe pandëshkueshmërisë, si dhe nivelin e ulët të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar në mënyrë të kundërligjshme", ka deklaruar ai. Megjithatë, Havolli ka thënë se Agjencia Kundër Korrupsionit është duke e kryer punën e vet dhe, sipas tij, mbi 100 raste janë duke u trajtuar për korrupsion. "Ndërsa sa iu përket rasteve të trajtuara për korrupsion gjatë tremujorit të këtij viti, sipas statistikave që ka Agjencia, ekzistojnë mbi 100 raste të cilat janë në procedurë trajtimi në Agjenci. Vlen të theksohet se

vetëm në vitin e kaluar kemi ushtruar mbi 105 kallëzime penale ndaj më shumë se 120 personave, pesë informata janë përcjellë në Policinë e Kosovës, tri informata janë përcjellë në Prokurorinë e Shtetit, një informatë është përcjellë në Administratën Tatimore të Kosovës", është shprehur Havolli, duke paralajmëruar se do të ketë zgjerim të kompetencave dhe forcim të rolit të AKK-së në luftimin e korrupsionit. Ai ka mohuar që të ketë presion nga politika në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Havolli është shprehur i kënaqur me mbështetjen e institucioneve në betejën për ta luftuar korrupsionin. "Asnjëherë nuk do të thosha presion, mirëpo mbështetje, pasi që luftimi i korrupsionit është mision i përbashkët i të gjitha institucioneve tona qoftë nga Qeveria, Kuvendi apo

institucionet e tjera të zbatimit të ligjit. Ne vazhdimisht kemi pasur dhe kemi përkrahje në çdo aspekt, nga të gjitha institucionet vendimmarrëse", ka theksuar Havolli.

"Epoka e re": Z. Havolli, të hënën ka përfunduar afati për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë. Si ka shkuar ky proces? E kanë deklaruar pasurinë të gjithë zyrtarët që kanë qenë të obliguar ta bëjnë një gjë të tillë?

Havolli: Procesi i deklarimit ka shkuar në rregull dhe ka përfunduar më 1 prill pasi data 31 mars i ka rënë të jetë ditë fundjave. Prandaj, në bazë të ligjit, afati është shtyrë edhe për një ditë, pra më 1 prill.

"Epoka e re": Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) a do ta verifikojë pasurinë e këtyre zyrtarëve të cilët, mbase, edhe

mund të mos e thonë të vërtetën?

Havolli: Agjencia Kundër Korrupsionit do ta bëjë verifikimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë sipas legjislacionit, e që këtij verifikimi i nënshtrohet 20 për qind e listës së përgjithshme të zyrtarëve të lartë. Mirëpo ky numër mund të rritet në rast të denoncimeve nga subjektet e tjera kur ka dyshime të arsyeshme për deklarim të rremë.

"Epoka e re": Z. Havolli, të gjithë në Kosovë flasin për luftimin e krimit dhe korrupsionit, por në praktikë qytetarët nuk po i shohin rezultatet e duhura. Madje në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit është thënë se Kosova ka frenuar sa i përket luftimit të korrupsionit. Çfarë është duke bërë në këtë drejtim Agjencia të cilën e drejtoni?

Havolli: Sa i përket raportit të

alimin dhe luftimin e korrupsionit

mandatit ligjor që ka ushtron kompetencat e veta të përcaktuara me ligj në aspekt të parandalimit të rasteve të konfliktit të interesit, mbikëqyrjes së procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik, si dhe në raste të dyshuara për korrupsion parashtron kallëzime penale në prokuroritë themelore si dhe, në rast të shkeljeve administrative, parashtron kërkesa për fillim të procedurës disiplinore.

"Epoka e re": Sa i përket luftimit të korrupsionit, AKK-ja si institucion a e arsyeton funksionimin e mëtutjeshëm? Mund të na tregoni se sa raste janë trajtuar në këtë tremujor të këtij viti për korrupsion?

Havolli: Sa i përket arsyetimit të funksionimit të mëtutjeshëm të Agjencisë në aspekt të luftimit të korrupsionit, duhet theksuar një gjë shumë me rëndësi se aktualisht është duke u punuar në zgjerimin e kompetencave dhe në forcimin e rolit dhe rëndësisë së Agjencisë si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore në luftën kundër korrupsionit. Së fundmi duhet përmendur Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve i cili, në dispozitat që përmban, konsiderohet si një segment kundërkorrupsionit shumë me rëndësi dhe i cili ndikon në fuqizimin e rolit dhe rëndësisë së Agjencisë, si një nga mekanizmat mjaft të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Ndërsa sa i përket rasteve të trajtuara për korrupsion gjatë tremujorit të këtij viti, sipas statistikave që ka Agjencia, ekzistojnë mbi 100 raste të cilat janë në procedurë trajtimi në Agjenci. Vlen të theksohet se vetëm vitin e kaluar kemi ushtruar mbi 105 kallëzime penale ndaj më shumë se 120 personave, pesë informata janë përcjellë në Policinë e Kosovës, tri informata janë përcjellë në Prokurorinë e Shtetit, një informatë është përcjellë në Administratën Tatimore të Kosovës. Për më tepër hollësi, sa i përket statistikave të rasteve të trajtuara, mund t'i gjeni në Raportin Vjetor të Punës për vitin 2018 i cili është i publikuar në uebfaqen e Agjencisë.

"Epoka e re": Keni presion nga politika për luftimin e kësaj dukurie apo e keni mbështetjen e duhur të Qeverisë dhe Kuvendit në këtë betejë të rëndësishme për vendin?

Havolli: Asnjëherë nuk do të

thosha presion, mirëpo mbështetje, pasi që luftimi i korrupsionit është mision i përbashkët i të gjitha institucioneve tona qoftë nga Qeveria, Kuvendi apo institucionet e tjera të zbatimit të ligjit. Ne vazhdimisht kemi pasur dhe kemi përkrahje në çdo aspekt, nga të gjitha institucionet vendimmarrëse, Ministria e Drejtësisë, Kuvendi dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit qoftë në krijimin e infrastrukturës ligjore si dhe në shumë aspekte të tjera

bashkëpunimi dhe bashkëveprimi, me qëllim që të arrihen rezultate më të mira.

"Epoka e re": Jeni të kënaqur me nivelin e bashkëpunimit të AKK-së me prokurorinë dhe gjykata si institucione përgjegjëse për luftimin e korrupsionit? Do të ketë ndonjë strategji apo shtim të masave në luftimin e korrupsionit?

Havolli: Ekziston një nivel i kënaqshëm i bashkëpunimit në mes të Agjencisë dhe institucioneve të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera si: prokurorin, policinë, gjykatat dhe institucioneve të tjera.

Informacionet kthyese si dhe komunikimi i lehtësuar në fazat e hetimeve, së bashku me shkëmbimin e informacioneve dhe dokumentacionit, kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së bashkëpunimit reciprok në mes të organeve të zbatimit të ligjit dhe organeve gjyqësore. Ky nivel bashkëpunimi gjatë gjithë kohës është duke u avancuar. Bashkërisht si institucione të zbatimit të ligjit jemi duke bërë përpjekje të vazhdueshme që niveli ndërinstitucional i bashkëpunimit të forcohet dhe në të ardhmen të tejkalohet si sfida në mes nesh.

Presidenti Thaçi: Ejup Runjeva ishte model i luftëtarit të lirisë

KAÇANIK, 2 PRILL (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë të martën në akademinë përkujtimore të gjashtëvjetorit të ndarjes nga jeta të luftëtarit të UÇK-së, Ejup Runjeva. Presidenti Thaçi ka thënë se Ejupi ishte prej veprimtarëve të parë që iu bashkëngjiti Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në këtë pjesë të Kosovës. "Ejupi ishte luftëtar i orëve të para dhe shquhej për shkathhtësitë e tij të jashtëzakonshme të mobilizimit, afrimit, urtësisë dhe trimërisë në veprimet e tij. Ai ishte modeli i luftëtarit të lirisë. Modeli i një luftëtarit që na duhej në atë kohë, i duhej kauzës, i duhej qëllimit tonë për liri, për

pavarësi dhe idealit madhor për bashkim kombëtar", ka thënë Thaçi. Duke sjellë kujtimet më të mira për të, për trimërinë dhe rolin e tij udhëheqës në shumë angazhime, beteja, por edhe udhëtime të përbashkëta, presidenti Thaçi ka thënë se ka pasur nderin të kalojë me të në shumë angazhime të përbashkëta. "Kam pasur nderin që të kaloj së bashku me të në shumë angazhime të përbashkëta, të jemi së bashku përgjatë tërë bjeshkëve të Sharrit edhe në shi, edhe në borë, edhe në acar dhe vapë, gjithmonë në krye të kolonës, edhe në maje të Lubotenit", ka thënë ai.

Kreu i vendit ka shtuar se sot

me krenari përkujtojmë atë sakrificë të madhe të Ejupit dhe bashkëluftëtarëve të tij. "Ballëlar të qëndroi në luftë. Ballëlar të qëndroi pas luftës. Edhe pse u arrestua dhe u dënua padrejtësisht, përsëri ideal, aspirata dhe kauza e tij fituan. Gjithashtu, vlerësoj lart rolin e Ejupit në krye të shoqatave të luftës, pas luftës, për t'u përballur me shumë padrejtësi, por edhe për t'u përkujdesur për çdo luftëtar brenda mundësive, potencialeve dhe kapaciteteve që kishte", është shprehur Thaçi. Presidenti Thaçi ka theksuar se Ejupi vdiq në moshën më të mirë, kur ende kishte mundësi, potencial dhe kapacitet t'i shërbente vendit tonë.



fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, lidhur me faktin se Kosova ka ngecur në aspekt të luftimit të korrupsionit, mund të them se nuk jemi të habitur nga ky fakt apo konstatim në këtë raport, pasi ekzistojnë mekanizma të shumtë që vlerësojnë shkallën e korrupsionit në vendin tonë qoftë nga ne si agjenci, institucione të tjera publike, shoqëria civile dhe vlerësime të tjera nga jashtë duke konstatuar një gjendje jo të mirë sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, me theks të veçantë korrupsionin e nivelit të lartë dhe pandëshkueshmërisë, si dhe nivelin e ulët të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa sa i përket çështjes tjetër, se çka është duke bërë Agjencia Kundër Korrupsionit në këtë drejtim, Agjencia konform

Fillon realizimi i hulumtimit: Vlerësimi i faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike në Kosovë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 PRILL - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShKP), bazuar në vendimin e ministrit të Shëndetësisë, ka filluar realizimin e hulumtimit për vlerësimin e faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike në Kosovë - STEPS mbikëqyrja.

Qëllimi i STEPS hulumtimit është që ta përcaktojë shpërndarjen e faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike në Kosovë në mesin e popullatës së moshës 18 deri 69 vjet dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në rekomandimet e politikave dhe programeve në shëndetësinë publike.

Ky studim do ta përcaktojë

shkallën e disa prej faktorëve kryesorë të rrezikut për sëmundjet kronike jongsjtesë në Kosovë, si: përdorimi i duhanit, konsumimi i alkoolit, përdorimi i pakët i frutave dhe perimeve, përdorimi i lartë i kripës në dietë, mosaktiviteti fizik, shtypja e rritur e gjakut, obeziteti, rritja e glikemisë esull dhe niveli i lartë i yndyrave në gjak.

IKShKP-ja do të grumbullojmë informacion prej 3 072 pjesëmarrësve nga tërë Kosova në vendbanimet në të cilat hulumtimi do të realizohet gjatë tre hapave.

Reduktimi i faktorëve të rrezikut për shëndetin ka qenë preokupim i njerëzve, mjekëve dhe politikanëve gjatë historisë. Sëmundjet kronike jongsjtesë

vazhdojnë të dominojnë në mbarë botën. Ato janë përgjegjëse për shumicën e vdekjeve në nivel global. Gjithsej 56 milionë vdekje në mbarë botën janë shkaktuar në vitin 2012.

Prej këtyre, 38 milionë (68 për qind) ishin nga sëmundjet kronike jongsjtesë, veçanërisht sëmundjet kardiovaskulare, kanceri dhe sëmundjet kronike respiratore. Më 2030 këto shifra pritet të rriten në 52 milionë vdekje. Përafërsisht 42 për qind e vdekjeve nga sëmundjet kronike jongsjtesë janë premature dhe shkaktohen para moshës 70-vjeçare.

Ndryshueshmëritë në duhanpirje, shtypje të gjakut dhe obeziteti shpjegojnë



ndryshueshmëritë në mortalitetin prej sëmundjeve kardiovaskulare dhe kancerit si dhe jetëgjatësinë e pritur të jetës.

Ky hulumtim realizohet me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, zyra në Prishtinë.

Mjekët në Klinikën e Ortopedisë kryejnë artroskopinë e parë të krahut

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 PRILL - Në Klinikën e Ortopedisë një ekip i mjekëve specialistë ka kryer për herë të parë me artroskop një operim në krahun e një pacienti i cili, për shkak të lëndimeve të shpeshta, kishte dhembje të padurueshme dhe lëvizjet i kishte të kufizuara. Artroskopia është ndërhyrje kirurgjikale dhe kjo procedurë kryhet me anë të aparatit të artroskopit që përdoret për qëllime diagnostikimi dhe trajtimi të problemeve të ndryshme që mund të ketë artikulacioni (nyja).

Klinika e Ortopedisë është pajisur me këtë aparaturë dy muaj më parë nga Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve për pacientët.

Drejtori i Ortopedisë, Ilir Tolaj, ka thënë se me këtë aparaturë janë kryer intervenime edhe



më herët, por në gju. Tash me metodën minimale invazive, pa e bërë hapjen e nyjës, sipas Tolajt, është kryer një ndërhyrje kirurgjike edhe në krah. "Është një metodë e re të cilën po e fusim në përdorim si klinikë dhe besoj se edhe në të ardhmen do të kemi raste të

tilla më të shpeshta dhe në njëfarë forme ta bëjmë si rutinë", është shprehur Tolaj. Ai ka konstatuar se pacienti pas intervenimit mund ta lëvizë menjëherë krahun. Madje ai ka folur edhe për çmimin e një ndërhyrjeje të tillë jashtë institucioneve publike shëndetë-

sore. "Nëse do të trajtohej jashtë institucioneve publike ky lloj operacioni kushton diku 3 000 euro. Pacienti menjëherë pas operacionit fillon lëvizjen e krahut dhe i jepen këshillat për rehabilitim fizioterapeutik, normalisht gjithmonë rehabilitimi bëhet pa dhimbje", ka

theksuar ai.

Për natyrën e komplikuar të lëndimit ka folur edhe anesteziologu Agron Rugova. Ai ka thënë se te pacientët në moshë të shtyrë veprimet e anestezionit janë më të kufizuara duke e quajtur këtë sfidë jo të vogël. "Edhe për neve është pak më specifik për shkak të moshës që e ka pacienti. Është një pacient diku rreth 70 vjeç. Në këtë rast problemet shëndetësore na kufizojnë veprimin e anestezionit te këta njerëz, e sidomos pozita specifike, që duhet të ulet rreth 30 shkallë, domethënë në një pozitë gjysmë të drejtë të ulur që duhet gjithmonë pacientin ta përcjellim në aspektin hemodinamik", ka deklaruar Rugova.

Ndërsa Vasa Gashaj, pacientja e cila është operuar, ka thënë se nuk ka pritur gjatë për intervenim dhe se tash ndihet mirë dhe më nuk ka dhimbje.

Kosova shënon Ditën Botërore të Ndërgjegjësimit të Autizmit

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Në kuadër të 2 prillit, Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit të Autizmit, janë shënuar aktivitete të ndryshme edhe në Kosovë. Organizata "Asociacioni Nacional i Autizmit Kosovë" ka realizuar një organizim për shënimin e kësaj dite në përkrahje të personave me spektrin e autizmit, ku janë mbajtur aktiviteteve sensibilizuese në Sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, ngjarje e cila është përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në këtë manifestim mori pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, e cili e konsideroi këtë ngjarje të veçantë sepse organizohet për njerëz me aftësi të veçanta. "Këta fëmijë me vizatimet e tyre shprehin talentin e tyre të veçantë përmes pikturave të cilat i ekspozuan në sheshin e Prishtinës. Jam shumë i lumtur që si ministri kemi mbështetur edhe këtë aktivitet dhe projektet e kësaj natyre", u shpreh ministri Gashi. Ai ka thënë se si institucion do të përkrahin gjithmonë aktivitete

të kësaj natyre, "që ta rrisim ndërgjegjen dhe të edukohemi më tutje si shoqëri për autizmin dhe si të ballafaqohemi me të. Është detyrë e jona që personat e prekur nga çrregullimi i spektrit të autizmit t'i mbështesim dhe t'i kuptojmë dhe t'i ndihmojmë edhe familjet e tyre në çfarëdo forme", ka thënë Gashi.

Aktiviteti u shoqërua me grumbullimin e fondeve për t'i plotësuar nevojat e fëmijëve me autizëm, njëkohësisht u realizuan edhe performanca artistike nga artistë të ri.



Bytyqi kërkon nga SBASHK-u reflektim për zëvendësimin e orëve të humbura

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka takuar të martën përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), nga të cilët ka kërkuar të reflektojnë pozitivisht për zëvendësimin e të gjitha orëve të humbura në procesin mësimor. "Vlerësoj se është momenti i fundit për të reflektuar të gjitha palët dhe së bashku të ndërmarrim veprime që janë në interes të procesit mësimor dhe rritjes së cilësisë në arsim", ka thënë ministri Bytyqi



**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 2 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka zhvilluar të martën një takim me përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), me të cilët ka biseduar për situatën e krijuar dhe për vështirësitë e hasura në procesin e kompensimit të orëve të humbura gjatë grevës. Në kuadër të angazhimeve dhe përgjegjësi institucionale, ministri Bytyqi ka shprehur edhe një herë gatishmërinë e MASHT-it për bashkëpunim me SBASHK-un dhe me të gjithë aktorët e tjerë relevantë, duke ditur ndjeshmërinë që kanë proceset në sistemin tonë arsimor.

Fillimisht, ministri ka rikonfirmuar se vendimi për zëvendësimin e ditëve të humbura në procesin mësimor është

vendim ligjor, i domosdoshëm dhe në shërbim të nxënësve. Ai ka theksuar se ky vendim është rezultat i konsultave paraprake me drejtorë të Drejtorive Komunale të Arsimit, Këshillin e Prindërve dhe është bazuar në propozimet e tyre. Bytyqi ka pohuar se kundërshtimet e SBASHK-ut për moszbatimin e këtij vendimi e kanë vështirësuar implementimin e tij.

Ndërkohë, ka qenë dhe mbetet përgjegjësi e DKA-ve që të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi në gjithë Kosovën. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë takim kanë shprehur një kërkesë të re, e cila ka të bëjë me rritjen e koeficientit për paga për mësimdhënësit e klasave nga 1 deri në 5, respektivisht të zbatohet versioni fillestar për koeficientet për paga sipas draftligjit para se të arrihej marrëveshja. Ky kusht është vendosur nga SBASHK-u si kompromis për të zëvendësuar pesë ditë në fund të

vitit shkollor. Me këtë rast, ministri Bytyqi i ka informuar përfaqësuesit e SBASHK-ut se paraprakisht ka pranuar një peticion nga mësimdhënësit e klasave nga 1 deri në 5, të cilët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me koeficientin për paga dhe i ka siguruar ata për angazhim të fuqishëm për përmbushjen e kërkesave të tyre, duke ditur edhe faktin se nuk është drejtpërdrejt në kompetencat e MASHT-it për të bërë një ndryshim të tillë.

Ministri Bytyqi ka theksuar faktin se çështja e kompensimit të

orëve dhe rritja e koeficienteve janë dy procese të ndara, pasi kompensimi i orëve kërkon reagim të menjëhershëm. Gjithashtu, ai ka shprehur gatishmërinë e plotë për t'u angazhuar bashkërisht për realizimin e kërkesave të mësimdhënësit të kasave nga 1 deri në 5, duke përmbushur pjesën e angazhimeve që na takojnë, për faktin se ndryshime të tilla të ligjit janë jashtë kompetencave të MASHT-it dhe kërkojnë angazhim të shumë faktorëve institucionale. Ministri, po ashtu, ka theksuar faktin se aktualisht ligji nuk është në fuqi

dhe ndryshimet tani për tani janë të pamundura, por ka thënë se angazhimet në këtë drejtim do të mbesin të vazhdueshme. Në fund, ministri Bytyqi ka kërkuar nga SBASHK-u për të reflektuar pozitivisht dhe të bëjë thirrje tek të gjithë mësimdhënësit që të angazhohen për zëvendësimin e të gjitha orëve të humbura në procesin mësimor. "Vlerësoj se është koha e fundit për të reflektuar të gjitha palët dhe së bashku të ndërmarrim veprime që janë në interes të procesit mësimor dhe rritjes së cilësisë në arsim", ka thënë ministri Bytyqi.

Kurti me deputetë dhe veprimtarë politikë përkujtojnë demonstratat e '81-shit

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Të martën, më 2 prill, në përvjetorin e demonstratave të vitit 1981, një delegacion i Lëvizjes Vetëvendosje, i prirë nga kryetari Albin Kurti dhe deputetë dhe veprimtarë politikë, kanë bërë homazhe para pllakave përkujtimore të dëshmorëve të pranverës së vitit 1981. "Më datë 2 prill 1981 rrugët e Prishtinës, por edhe të qyteteve të tjera në Kosovë, u vërshuan nga protestuesit që e hapën pranverën politike duke e hapur çështjen shqiptare. 'Republikë-Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë', 'Jemi shqiptarë, nuk jemi jugosllavë', 'Bashkim-Bashkim', 'Trepça punon, Beogradi fiton' e parulla të tjera të ngjashme mbaheshin nga duart e mijëra studentëve dhe qindra punëtorëve që dolën në përkrahje të demonstratës që kërkonte të drejta e liri, çlirim e bashkim, nga një regjim që shfrytëzonte shqiptarët për të qëndruar", është thënë në komunikatën e LV-së.

Më tej, në këtë komunikatë të Lëvizjes Vetëvendosje thuhet se

"2 prilli i vitit 1981 renditet në vazhdimësinë e përpjekjeve që u shtuan në mars, e që vazhduan edhe gjatë prillit, pra të një kryengritjeje të përgjithshme që në përmbytje si diçka të re barte edhe avancimin e çështjes shqiptare nga segmente të demonstratës tek ato të luftës së armatosur. Studentë, militantë që kërkonin transformimin e gjendjes që i mbante shqiptarët të shtypur nën Jugosllavi, bashkë me punëtorë që iu bashkuan atyre në kërkesa, përcaktuan filltet e një ndryshimi të madh politik asokohe. Pushteti jugosllav, duke parë këtë situatë, përdori armatën e vet për t'i shtypur këto demonstrata".

Më 2 dhe 3 prill të vitit 1981 në demonstratën më të madhe të parë ndonjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva, si dy të rinj që qëndronin në ballë të demonstratës me flamuj, u qëlluan nga oficerë ushtarakë që ishin fshehur në një objekt banke para demonstruesve. "Bashkë me ta, dëshmorë në këtë demonstratë ranë



edhe Xhelal Maliqi, Salih Abazi, Salih Zeka, Ruzhdi Hyseni, Rizah Matoshi, Sherif Frangu dhe Nesimi Dervishdana. Të gjithë pra, të rinj që me trupat e tyre po e ngrinin zërin për liri dhe barazi kombëtare, për drejtësi e përparim shoqëror - u qëlluan me

gjakftohtësi nga regjimi i asaj kohe. Po atë ditë kur ndodhi ky krim, regjimi jugosllav shpalli edhe 'Gjendjen e shtetrrëthimit', ku u ndalua takimi i më shumë se tre vetave dhe qarkullimi nga ora 20:00 deri në orën 6:00 të mëngjesit. Kësisoj, veprimtarët, por

edhe një popull që kishte dalë në demonstratë, kaloi në një segment të dytë të organizimit, në një segment të tillë ku oficerët e fshehur nuk e panë më vetëm duarthatë", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

MZhE-ja: Termocentrali 'Kosova e Re', në pajtim me të gjitha kriteret ndërkombëtare të mjedisit

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Termocentrali 'Kosova e Re' do t'i plotësojë kriteret më të ashpra evropiane për mbrojtje të mjedisit dhe të ndërtohet në pajtim me teknikat më të mira ekzistuese. Kështu thuhet në buletin e muajit mars rreth sektorit energjetik, prezantuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE). Sipas MZhE-së, Termocentrali 'Kosova e Re' do t'i zvogëlojë emetimet e pluhurit për rreth 93 për qind, ato të dyoksidit të karbonit për rreth 38 për qind, të dyoksidit të sulfurit për rreth 85 për qind dhe të NOx për

rreth 93 për qind. "Standardet që duhet t'i përmbushin termocentralet caktohen nga rregulloret e Komisionit Evropian. Vendimi zbatues i Komisionit 2017/1442 i datës 31 korrik 2017, për themelimin e teknikave më të mira ekzistuese (BAT), në kuadër të Direktivës 2010/75/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian", thuhet në buletin e MZhE-së.

Përveç të tjerash, kjo teknologji e emëruar si 'ultra-super kritike' do të shënojë përmirësime edhe në efikasitet dhe në konsumin e ujit, që përdoret për



ftohje të impianteve, ani pse kjo nuk është e përcaktuar me direktivat evropiane. "Në të ardhmen, termocentrali 'Kosova e Re' do ta rrisë

kapacitetin e ngrohjes termike që do ta mundësojë zgjerimin e rrjetit në Prishtinë, Obiliq dhe Fushë-Kosovë. Kjo energji do të furnizojë me ngrohje 20 mijë

konsumatorë të rinj. Në këtë mënyrë, kogjenerimi largon varësinë nga energjia elektrike dhe burime të tjera alternative për ngrohje", thuhet në raport.

Hapet afati për aplikim për rimbursim nga kuponët fiskalë për tremujorin e parë të 2019-s



PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar qytetarët se nga 1 prilli deri 30 më prill mund të aplikojnë për rimbursim nga kuponët fiskalë për tremujorin e parë të 2019-s.

Aplikimi bëhet duke plotësuar aplikacionin për rimbursim të mjeteve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë. "Aplikacioni duhet të plotësohet në mënyrë elektronike përmes uebfaqes së Administratës Tatimore të

Kosovës në linkun Shërbime Elektronike - Aplikacioni për Kuponë Fiskalë. Aplikimi bëhet vetëm një herë për të njëjtin periudhë duke u bazuar në numrin personal të aplikuesit", është bërë me dije në njoftimin

e ATK-së. Fituesit potencialë do të rimbursohen me 10 për qind të vlerës së deklaruar, por jo më shumë se 100 euro. Numri minimal i kuponëve fiskalë të dorëzuar duhet të jetë 60

kuponë, me shumën minimale 250 euro. ATK-ja ka bërë me dije se aplikuesit të sigurohen që xhirollogaria bankare të cilën e kanë deklaruar në aplikacion për rimbursim të jetë funksionale.

Bedri Istrefi takon Sindikatën Profesionale të Telekomit, flasin për zhvillimet në këtë ndërmarrje

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, në vazhden e zhvillimeve të fundit në Telekom, sot ka takuar përfaqësuesit e Sindikatës Profesionale të Telekomit të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për gjendjen e përgjithshme në këtë ndërmarrje, për sfidat dhe vështirësitë, si dhe për strategjinë e zhvillimit të kompanisë sonë. "Pa dyshim se

sindikata luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve dhe ruajtjen e mirëqenies së tyre, por edhe për arritjen e synimeve strategjike për zhvillimin e kompanisë sonë. Unë shpreha gatishmërinë time të diskutoj për çdo çështje me interes të përgjithshëm për Telekomin e Kosovës", ka shkruar kryeshefi i Telekomit në logarinë e vet në "Facebook".



Banka Botërore: Rritja ekonomike pritet të jetë 4.5 për qind



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 PRILL - Zyrarët e Bankës Botërore në Kosovë kanë prezantuar të martën raportin e rregullt ekonomik të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. Me këtë rast, drejtori i Bankës Botërore në Prishtinë, Marco Mantovanelli, ka thënë se sa iu përket shteteve të rajonit, Kosovë, Shqipëri, Serbi, Maqedoni, ka lajme pozitive. Mantovanelli ka thënë se Kosova është ndër vendet me rritjen më të madhe ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me 4.2 për qind. Sipas tij, në vitin 2019 kjo rritje pritet të jetë 4.5 për qind. "Sa i përket Kosovës, ne kemi vlerësuar një rritje për vitin 2018 me 4.2 për qind.

Është një prej rritjeve më të mëdha. Kjo është bërë nga investimet private dhe publike. Pastaj eksportimi i shërbimeve që kanë të bëjnë kryesisht me diasporën. Kemi vlerësuar se kjo rritje do të jetë e qëndrueshme, por kjo rritje duhet të materializohet edhe me vende të punës. Ka një zvogëlim në punëdhënie. Shqetësimi është se nuk ka vende pune. Ka të rinj që dalin nga arsimit dhe dëshirojnë t'i bashkohen tregut të punës. Nga ana e rrezikut po shohim shpenzimet publike që po shkojnë kah pagat, pastaj përfitimet e disa kategorive si ata të luftës dhe të tjerëve", ka thënë Mantovanelli. Ai ka pohuar se pret rezultate pozitive edhe për tre vjetet e ardhshëm sa i përket zhvillimit

ekonomik. "Projeksionet për tre vjetet e ardhshëm janë pozitive për Kosovën, megjithatë kemi rreziqe të jashtme, duke marrë parasysh se çfarë po ndodh me vendet evropiane. Tani është koha që të shtyjme përpara krijimin e kapitalit njerëzor dhe konkurrueshmërinë dhe produktivitetin njerëzor. Kjo është me rëndësi për të krijuar hapësirë në buxhet", ka deklaruar ai. Sipas raportit të Bankës Botërore, mbi 17 mijë vende të punës kanë humbur në vitin 2018, ndërsa shkalla e papunësisë është rritur gjatë vitit të kaluar. Mantovanelli ka kërkuar që të rritet efikasiteti i shpenzimeve në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Sa iu përket shpenzimeve për skemat

sociale, ai ka thënë se Kosova duhet të jetë më fleksibile në mënyrë që skemat të shkojnë aty ku është nevoja. Ai ka folur edhe për projektin 'Kosova e re', duke bërë me dije se mundësia për t'i financuar projektet me bazë të thëngjillit është bërë i pamundur nga Banka Botërore. Mantovanelli ka theksuar se Banka Botërore synon mbështetjen e energjisë së ripërtëritshme. Kurse ekonomistja e Bankës Botërore, Asli Senkal, ka thënë se pavarësisht rritjes ekonomike në Kosovë që është e fuqishme, ajo është edhe e cenueshme. "Konsumi është rritur dhe kjo është shtyrë nga pagat më të larta, remitencat dhe kreditë konsumuese më të larta. Eksportet neto janë tkurrur. Turizmi është rritur në anën

tjetër. Po ashtu, edhe eksportet e turizmit janë rritur. Këto janë rritur nga diaspora. Derisa rritja ka qenë e fuqishme në vitin 2018, kjo jo domosdoshmërisht është kthyer në krijim të vendeve të punës. Numri i të punësuarve është zvogëluar në fabrika dhe bujqësi, ndërsa është rritur në sektorët me shumicë dhe pakicë", ka thënë ajo. Senkal ka pohuar se edhe shkalla e papunësisë në vitin 2018 është rritur për shkak të shkallës së joaktivitetit. "Kjo nënkupton se Kosova është popullatë e re dhe popullata e aftë për punë është në rritje. Tregu i punës është i vogël me 14.8 për qind, që është tregu më i ulët në rajon", ka thënë ajo. Sipas saj, një rritje ekonomike prej 4.5 përqindësh parashihet në dy vjetet e ardhshëm.

Ministri Shala: Kënaqësi kur sheh prodhuesit vendorë që janë konkurrues për tregjet e huaja

DRAGASH, 2 PRILL (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka vizituar kompaninë e përpunimit të mishit "Meka". Ai ka thënë se është kënaqësi kur sheh prodhuesit vendorë që janë duke krijuar produkte konkurruese edhe për tregjet e huaja. "Sot isha për vizitë në Komunën e Dragashit bashkë me zëvendësministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, në kompani-

inë e përpunimit të mishit 'Meka', që prodhon pastetë, salame dhe suxhuk shumë kualitativ. Pronarin e kompanisë 'Meka', Burim Piraj, e informova se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me Bankën Botërore kanë filluar një skemë të re për t'u dalë në ndihmë bizneseve vendore në certifikimin e produkteve për t'i eksportuar në vendet e BE-së", ka shkruar ministri Shala në llogarinë e vet në "Facebook".

Ministri Shala ka vizituar edhe kompaninë "Hit Flores" që grumbullon fruta mali dhe i eksporton në tregjet e huaja. "Kompanitë si 'Meka' dhe 'Hit Flores' po ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, hapjen e vendeve të reja të punës, si dhe përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, që po i inkurajon të bëjnë investime të reja dhe t'i zgjerojnë kapacitetet prodhuese", ka thënë Shala.



Muharremaj kërkon angazhime shtesë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

Suharekë, 2 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka kërkuar angazhime shtesë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e kësaj komune. Ai ka bërë me dije se të gjitha projektet e parapara për vitin 2019 do të realizohen sipas

dinamikës së paraparë. "Me angazhime shtesë kam kërkuar që të vazhdojnë punët në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Të gjitha projektet për këtë vit do të realizohen sipas planifikimit", ka thënë Muharremaj.



Vazhdon realizimi i projekteve në Malishevë në rrugën e transitit dhe lumin Mirusha

MALISHEVË, 2 PRILL (ER) - Në Komunën e Malishevës është duke u punuar intensivisht për realizimin e dy projekteve me rëndësi të madhe për këtë komunë, rregullimi dhe ndërtimi i rrugës së transitit për qytetin dhe rregullimi i shtratit të lumit Mirusha.

Punimet në realizimin e këtyre dy projekteve kapitale të martën i kanë parë nga afër nënkryetari i Komunës së Malishevës,

Hajdin Berisha, dhe drejtori për Ekonomi dhe Financa, Valon Mazreku, të cilët janë ndarë të kënaqur me punimet e deritanishme. Aktualisht është duke u punuar në segmentin e tretë të rrugës së transitit dhe punimet janë duke shkuar sipas planifikimeve.

Rruga e transitit është rrugë tërësisht e re dhe paralelisht është duke u bërë hapja dhe krijimi i bazës së rrugës. Po ashtu,

edhe në lumin Mirusha, që kalon përgjatë qytetit, janë duke vazhduar punimet për rregullimin e shtratit të lumit. Sipas projektit, përveç shtratit të lumit do të rregullohet edhe pjesa anësore përgjatë lumit, ku do të ketë shtigje për ecje në të dyja anët e lumit.

Rregullimi i shtratit të lumit ka rëndësi të madhe për parandalimin e vërshimeve që shkakton lumi.




Ekipe emergjente në Mitrovicë mobilizohen për parandalimin e zjarreve

MITROVICË, 2 PRILL (ER) - Të martën në ambientin e Komunës së Mitrovicës, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri, ka mirëpritur në takim përfaqësues të policisë së Kosovës dhe përfaqësues nga Njësia e Zjarrfikësve. Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me ngritjen e kapaciteteve për rastet emergjente, ku kohët e fundit vendet rurale të Komunës së Mitrovicës po ballafaqohen me problemin e zjarrvënies së qëllimshme. Me këtë rast, përfaqësuesit e policisë janë shprehur të gatshëm

të ndihmojnë me të gjitha kapacitetet që kanë në dispozicion, për të reaguar me kohë kur paraqiten rastet me emergjente siç është problemi i zjarrit.

Ndërsa drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri, ka thënë se stafi komunal është në kontakt me ekipet emergjente dhe janë duke e përcjellë situatën, prandaj duhet të ndërmarrin edhe hapa më konkretë për ta evituar këtë problem. "Në bazë të informatave dhe inspektimeve të vazhdueshme nga drejtoria jonë, situata nuk është shumë e

kënaqshme, sepse numri i zjarreve është shqetësues në gjithë territorin e Kosovës, ditët e fundit edhe në Mitrovicë. Prandaj ne duhet të ndërmarrim sa më parë masa për ta ndaluar këtë dukuri", ka thënë Bahtiri. Në fund të takimit të pranishmit u pajtuan që disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës të trajnohen nga përfaqësuesit e zjarrfikësve me një trajnim dyditor lidhur me planin e veprimit për përdorimin e mjeteve për shuarjen e zjarreve si dhe apeluan te të gjithë qytetarët e komunës që t'i ruajnë hapësirat pyjore.



Fillon procesi i përzgjedhjes së administratorëve të këshillave lokale në Kaçanik



KAÇANIK, 2 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, dhe nënkryetari Ylber Bajra, kanë udhëhequr mbledhjen e fillimjavës në këtë komunë, në të cilën janë prezantuar aktivitetet komunale të realizuara në javën që lamë pas si dhe planifikimet për këtë javë. Në këtë takim fillimisht është bërë me dije se muaji mars ka pasur aktivitete dhe punë komunale dhe angazhim për parapërgatitjen e fillimit të shumë projekteve kapitale të

cilat pritet së shpejti të fillojnë së realizuari.

Drejtori i Administratës së Përgjithshme, Festim Neziraj, ka bërë me dije se ka filluar procesi i zgjedhjes së administratorëve të këshillave lokale në Komunën e Kaçanikut. Ai ka inkurajuar edhe femrat që të jenë pjesë e këtij procesi zgjedhor.

Ky proces do të fillojë më 8 prill dhe do të përfundojë më 6 maj, ndërsa në të do të përfshihen të gjitha vendbanimet e Komunës së Kaçanikut.

Ndërkaq drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Ramadush Osmani, ka thënë se kanë filluar punimet në projektin asfaltimi i rrugës 'Man Dashi-Stagovë', projekt ky në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës. Në anën tjetër, drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Bahri Selimi, ka thënë se 14 biznese në Kaçanik do të pajisen me mjete pune, të përkrahur nga organizata "HELP" në bashkëfinancim me Komunën e Kaçanikut.

Aforizma për politikanët që dëgjojnë (III)



Prof. Lisen BASHKURTI

- Politikani ndryshon nga shtetari si pjesa me të tërën.
- Politikani e konsideron qytetarin si votues, ndërsa shtetari e konsideron votuesin si qytetar.
- Për politikanin dita më e rëndësishme është ajo e votimit, ndërsa për shtetarin dita më e rëndësishme nis pas ditës së votimit.
- Politikani e ndan popullin në grupe elektorale, shtetari e bashkon elektoratin në unitet mbarëpopullor.
- Politikani e ndan kohën në segmente mandatesh, shtetari i lidh segmentet e mandateve në shtrirje afatgjatë.
- Politikani e fragmenton territorin në parcela elektorale, shtetari e unifikon territorin mbi kohezion territorial.
- Politikani e ndan ekonominë

në kategori shoqërore dhe grupe interesi, shtetari e zhvillon ekonominë mbi kohezion social ekonomik.

- Politikani mendon për kohën e vet, shtetari mendon për kohët që vijnë.

- Krizat janë dukuri universale dhe të përhershme, prandaj fuqia e liderëve politikë ka të bëjë me aftësinë e parashikimit, parandalimit dhe zgjidhjes paqësore të tyre.

- Vlera më e madhe e politikanit të kohës sonë është aftësia për bisedë, dialog dhe negociatë, sepse biseda, dialogu dhe negociatat dëshmojnë nivelin e qytetërimit të politikanëve, individëve, grupeve, komuniteteve dhe popujve, ndërkohe që arroganca dhe dhuna dëshmojnë nivelin e primitivizmit të tyre.

- Politika pa aftësi diplomatike është e ngurtë dhe konfrontuese. Diplomacia pa principe politike është e thyeshme dhe e paqëndrueshme.

- Diplomacia, përpara se të jetë profesion, është mision - mision i paqes në kohë lufte dhe mision i prosperitetit në

kohë paqeje.

- Diplomati, juristi dhe politikani janë tri hallka të një procesi, sepse diplomati negocion, juristi drafton tekstin, politikani vendos. Asnjëri nuk bën pa tjetrin.

- Në politikë kompromisi është mekanizmi për zgjidhjen e krizave, ndërsa diplomacia është rruga për arritjen e kompromisit. Por, ndërsa kompromisi është i përkohshëm dhe për çështje të caktuara, diplomacia është e përhershme dhe universale.

- Politikani nuk çmohet vetëm nga volumi i dijeve që ka në kokë por, para së gjithash, nga aftësia për t'i përdorur dijet dhe përvojat e veta dhe të njerëzve rreth vetes në kohën, vendin dhe mënyrën e duhur.

- Për politikanin mënyra më e vyer për ta lartësuar veten dhe për ta çmuar kohën e tij është leximi dhe dëgjimi, sepse nga leximi dhe dëgjimi politikani kurrë nuk humbet.

- Shpesh në politikën e ditës thuhet se gjithçka është para, por për politikanin e mençur para e vërtetë është arsimimi i popullit të tij.

- Respektin për të ardhmen ndaj popullit dhe kombit të vet politikani e shpreh në investimin për mësuesit dhe profesorët.

- Nga të gjitha burimet pasurore që mund të ketë një vend, më i rëndësishëm është burimi njerëzor.

- Politika e mirë investon në arsim më shumë se kudo, sepse çdo investim material e monetar vlerësohet e ç'vlerësohet, vetëm investimi në arsim tek njerëzit mbetet kapital i përjetshëm.

- Shumëkush mendon se fuqia kombëtare varet nga territori, popullsia apo pasuritë, ndërkohë që koha ka provuar se elementi më i rëndësishëm i fuqisë kombëtare është arsimimi i popullsisë.

- Vende të pasura me popullsi të paarsimuar mbeten përherë të varfra, ndërkohë që vendet e varfra me popullsi të arsimuar herët a vonë bëhen të pasura.

- Popujt e vendet e vegjël kanë nevojë për liderë të mëdhenj që të kompensojnë atë që objektivisht u mungon.

- Popujt e vendet e vegjël nuk i rrezikojnë aq prania dhe monitorimi i ndërkombëtarëve, por më shumë izolimi dhe

harresa prej tyre.

- Politikat kombëtare pa parime demokratike janë të rrezikshme, ndërsa parimet demokratike jashtë interesave kombëtare janë të padobishme.

- Sa më shumë që bota shkon drejt integriteteve dhe globalizmit aq më shumë lypet të forcohen identitetet kombëtare, sepse integritet dhe globalizmi i ekspozojnë identitetet kombëtare përballë konkurrencës së pamëshirshme.

- Mbrojtja dhe kontrolli i territorit shtetëror është prioritet edhe në kushtet e integriteteve dhe globalizmit, sepse territori është e vetmja hapësirë ku popujt lindin dhe kristalizojnë identitetet e tyre kombëtare, politike, ekonomike dhe sociale.

- Cenimi i territorit shtetëror ose dalja jashtë kontrollit e tij përbën kërcënim shumë serioz për vetë identitetin kombëtar, politik, ekonomik dhe shoqëror të popullit.

- Shkëmbimet apo cenimet territoriale shtetërore janë lëkundje tektonike komplekse, fundi i të cilave është zor të parashikohet.

Ndërron jetë ciceroni i parë i Kompleksit Memorial 'Adem Jashari', Rifat Bejta

SKENDERAJ, 2 PRILL (ER) - Ka ndër-ruar jetë ciceroni i parë i Kompleksit Memorial 'Adem Jashari', Rifat Bejta. Ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se me dhembje të thellë ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të veprimtarit të çështjes kombëtare, mësimdhënësit, veteranit të UÇK-së, ciceronit të parë të Kompleksit Memorial 'Adem Jashari', Rifat Bejta. "Ai gjithë jetën ia kushtoi atdheut. Jetëshkrimi i tij është jetëshkrim i një patrioti të madh që nuk u ndal asnjëherë për të punuar në shërbim të vendit! Ngushëllime më të sinqerta për familjen Bejta", ka thënë Sami Lushtaku. Kontributi i Bejtës, i cili ka qenë luftëtar i UÇK-së, është vlerësuar lart nga presidenti Hashim Thaçi dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli. Ata i kanë shprehur ngushëllime familjes Bejta me rastin e vdekjes së Rifat Bejtës. Fillimisht Thaçi ka thënë se është i pikëlluar me rastin e ndarjes nga jeta të veteranit të UÇK-së, Rifat Bejta. Me këtë rast, Thaçi i ka shprehur ngushëllime familjes Bejta. "Me



pikëllim mora lajmin për vdekjen e veprimtarit të njohur dhe veteranit të UÇK-së, Rifat Bejta. Familjes së tij i shpreh ngushëllimet më të sinqerta", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka ngushëlluar familjen Bejta për vdekjen e familjarit të tyre, Rifat Bejta. Ai ka thënë se veteranit të UÇK-së, Rifat Bejta, gjithmonë do të kujtohet si atdhetar dhe njeri i vlerave. "U

ndjeva i pikëlluar nga lajmi për vdekjen e mësuesit dhe veteranit të UÇK-së nga Prekazi, Rifat Bejta. Për shumë vjet pas luftës mësuesi Rifat ishte ciceron në Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'. Përmes zërit të tij, plot

kulturë dhe njohuri, miliona njerëz e dëgjuan rrëfimin për epopenë e Prekazit. Do ta mbajmë në mendje gjithmonë si njeri të vlerave dhe përkushtimit atdhetar", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

E jashtëzakonshme

Hamburgeri tre kilogramë që kushton 900 dollarë

Një restorant në Tokio po shënon kurorëzimin e Perandorit të ri japonez muajin e ardhshëm, me një hamburger me përmasat e një topi futbolli, të shërbyer mes një kulaçi të lyer me pluhur ari, me një kosto prej 900 dollarësh. Hamburgeri perandorak peshon tre kilogramë dhe është përgatitur nga



kuzhinierët në një lokal mishi në distriktin Roppongi të Tokios dhe ka dalë në shitje të hënën.

BARSOLETA E DITËS



Një fëmijë i vogël rrihet nga fqinja. Nëna e tij, shumë e nevrkosur, shkon t'i kërkojë shpjegime:
 - A mund ta di pse e keni rrahur djalin tim?
 - Se është i paedukuar. Më tha trashaluge.
 - Dhe çfarë mendoni ju zonjë, se duke e rrahur djalin tim do të dobësoheni?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
 Regjia: Dean DeBlois



FOTO E DITES



Disa artistë në Pragë shihen duke lëvizur në një litar përballë Manastirit Emmaus. /AFP/

Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

“THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

“CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

“U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E rrallë

Zbulohet varr masiv dinozaurësh

Një paleontolog ka zbuluar varrezën 66 milionë vjeçare të groposur nga cunami i cili shfarosi 75 për qind të jetës në tokë. Bëhet fjalë për zonën e Dakotës së Veriut, rreth 66 milionë vjet më parë, valët sizmike me origjinë nga një



tërmet me magnitudë 10, shkatërruan 75 për qind të jetës në tokë.

 <p>DASHI Sot një ditë plot energji për ju. Po jepni shumë në një drejtim të caktuar dhe pretendimet tuaja janë rritur po kaq. Do të kërkonit atë që ju takon.</p>	 <p>DEMI Po shikoni me zili ata persona që, edhe pse nuk mundohen fare, arrijnë atë që duan. Nga ana tjetër ju po bëni edhe punët e të tjerëve pa u vlerësuar.</p>	 <p>BINJAKËT Miqësitë janë ato që do të favorizohen sot dhe mund të marrin të gjithë ditën tuaj. Jeni të gatshëm të qëndroni pa fund me miq të mirë.</p>	 <p>GAFORRJA Kjo e sotmja nuk do të jetë nga ato ditë që do të donit t'i kujtonit. Do të keni probleme që në mëngjes herët.</p>	 <p>LUANI Po ju pëlqen çdo gjë që bëni sot si të rri në shoqërinë e familjarëve ashtu edhe kënaqësia që po ndjeni në ambientin e punës pas një projekti të realizuar.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Disa hije dyshimi ju kanë filluar për një raport të nisur së fundmi. Jeni në kohë të mendoheni dhe të tërhiqeni nëse gjërat nuk ju pëlqejnë.</p>
 <p>PESHORJA Sot ju duket sikur gjithë bota e ka me ju dhe jeni i vetëm kundër të gjithëve. Mbase nuk jeni zgjuar me energji të mira dhe ekzagjeroni çdo gjë.</p>	 <p>AKREPI Përveçse ditë e mërzi-shme, sot do të gjendeni edhe pa financa të mjaftueshme. Do të gjeni zgjidhje gjatë pjesës së dytë të ditës.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot po i orientoni të gjitha gjërat në drejtimin që juve ju intereson. Keni një plan të qartë për të ardhmen që doni ta zbatoni sa më shpejt.</p>	 <p>BRICJAPI Dita e sotme do të kalojë duke u marrë me problemet e familjes suaj të vogël. Keni neglizhuar disa gjëra që tashmë janë kthyer në diçka serioze.</p>	 <p>UJORI Sot jeni të gatshëm të shkoni pas kujt do që do t'ju ftonë në një udhëtim. Ju ka kapur shpirti i aventurës dhe doni të eksploroni vërdallë.</p>	 <p>PESHQIT Është gjithmonë dikush që kujdeset për ju dhe ju këshillon në ato çaste që kërkonin mbështetjen e personave të afërm.</p>

Emma Roberts e konfirmon se ka të dashur të ri

Duket se të gjitha raportimet ishin të sakta, Emma Roberts dhe Garret Hedlund janë në lidhje dashurie. Çifti kanë konfirmuar të gjitha thashethemet kur janë parë duke ecur dorë për dorë në qytetin e Nju Jorkut. Në fotografitë e kapura nga paparacët, aktorja 28-vjeçare dukej shumë e buzëqeshur derisa po ecte bashkë me të dashurin e saj, yllin e "Triple Frontier".




Zayn Malik trondit fansat kur thotë se ende e do Gigin



Këngëtari britanik-pakistanez, Zayn Malik, dhe e dashura e tij, modeluesja Gigi Hadid, pas pothuajse pas katër vjetësh bashkëjetesë, janë ndarë në janar të këtij viti. Zhurma e fundit në lidhje me çiftin është se të dy kurrë nuk do të shkojnë drejt pajtimit pasi Gigi mendon se Zayn Malik ka ende shumë çështje. Ndonëse të dy më parë kanë thënë se ende kanë

ndjenja për njëri-tjetrin, të ktheheshin bashkë nuk ishte një opsion për ta. Por, Zayn Malik tronditi fansat kur ai bëri një postim në "Twitter" se ende e do Gigin. Megjithatë, duket se çifti nuk ka mundësi të kthehet bashkë, sepse Gigi beson se Zayn ka disa çështje të mëdha. Një burim i afërt me Gigi tha për "Us Weekly" se kohët e fundit Gigi dhe Zayn janë ende duke folur.



Pasi i tha jo kandidaturës për presidente, Kimi rikthehet fuqishëm

Kim Kardashian shfaqti linjat e mrekullueshme teksa po reklamonte një 'bodysuit' nga linja e re e motrës së saj, Kourtney Kardashian. Kimi ka postuar një fotografi në "Instagram", në të cilën u shfaq me një veshje, i cili i mbulonte

vetëm pjesët intime. Fotoja provokuese erdhi vetëm një ditë pasi ylli i shout u rikthye në ekran në sezonin e 16 të "Keeping Up With Kardashian". Një ditë më parë Kimi hodhi poshtë edhe zërat për të kandiduar si presidente e ShBA-së në vitin 2020.

Këngëtari i famshëm gënjeu se do të bëhej baba për 1 prill

Këngëtari i famshëm Justin Bieber i ka emocionuar shumicën e fansave me lajmin se do të bëhet baba. Ai përmes rrjetit social "Instagram" ka publikuar një fotografi ku



ka thënë se pret që të bëhet baba. Mirëpo e gjithë kjo nuk ishte një lajm i vërtetë, por vetëm një gënjeshtër për ditën e 1 prillit. Për të shuar çdo dyshim, këngëtari ka publikuar një fotografi të bashkëshortes derisa kontrollohej te mjekët, ku dukej barku i rumbullakosur.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Batatina: Nuk diskutohet fitorja ndaj Ferizajt

Fitorja është opsioni i vetëm për Tahir Batatinën dhe Llapin në ndeshjen ndaj Ferizajt, e cila zhvillohet sot në stadiumin "Zahir Pajaziti". "Mungesa nuk kemi dhe jemi mirë të përgatitur që edhe ndaj Ferizajt do ta marrim maksimumin e pikëve. Fillimisht synim kemi aplikimin e lojës së mirë, më pas edhe fitoren", ka thënë Batatina për "Epokën e re"



Ferizajt dhe në ndeshjen që zhvillohet sot (e mërkurë) në stadiumin "Zahir Pajaziti" synon të dalë i pamposhtur. "Favorit është Llapi. Ne do të përpiqemi të prezantohemi sa më mirë që është e mundur në Podujevë. Në çdo ndeshje përpiqemi ta japim maksimumin. Edhe në këtë ndeshje do të përpiqemi në maksimum, por mbetet të shihet se çfarë do të ndodhë", ka deklaruar Sokoli. Krahas ndeshjes Llapi - Ferizaj, sot takohen edhe Drenica - Gjilani dhe Drita - KEK-u.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 PRILL - Trajneri Tahir Batatina është i bindur se skuadra e Llapit do të shënojë fitore ndaj Ferizajt, pasi në skuadër ka lojtarë shumë cilësorë të cilët, sipas tij, janë luaj të vërtetë dhe janë në gjendje ta japin shpirtin në fushë për të arritur deri te fitorja. "Në skuadër kam lojtarë cilësorë, të edukuar dhe shumë profesionistë. Shumë shpejt e kanë kuptuar filozofinë e lojës sime dhe mënyrën se çka dua të shfaq në një ndeshje unë si

trajner. Më gëzon fakti se djemtë janë të motivuar dhe në klub e kam harmoninë më të mirë në Superligë, pasi lojtarët për mua janë në gjendje të vdesin në fushë për t'i arritur pikët e plota. Kjo më bën të ndihem komod kur kam punë me luaj të vërtetë dhe afër vetes i kam djemtë më të mirë në Kosovë", ka thënë Batatina, duke shtuar: "Mungesa nuk kemi dhe jemi mirë të përgatitur që edhe ndaj Ferizajt do ta marrim maksimumin e pikëve. Fillimisht synim kemi aplikimin e lojës së mirë, më pas edhe fitoren".

Skuadra e Llapit e ka ngushtuar

diferencën e pikëve me dy skuadrat e para, Feronikelin dhe Prishtinën, dhe kjo nuk e ka vënë në presion aspak skuadrën nga Podujeva. "Nuk kemi presion dhe lirisht mund të them se jemi skuadra në pozitën më të mirë në kampionat sa i përket presionit. Ne futemi në ndeshje për të luaj-

tur lojën tonë pa asnjë ngarkesë dhe me lojë të mirë të arrijmë deri te fitoret", ka shtuar Batatina. Ndeshja ndaj Llapit do të jetë e veçantë për trajnerin Bylbyl Sokoli, pasi në fillim të këtij kampionati ishte trajner i kësaj skuadre. Megjithatë, tash "Profa" është në krye të skuadrës së

IPKO SUPERLIGA

Të mërkurën takohen:
Trepça '89 - Flamurtari
Llapi - Ferizaj
Drenica - Gjilani
Drita - KEK-u

Të enjten takohen:
Feronikeli - Ballkani
Prishtina - Liria

Ahmeti: Stadiumi është i Prishtinës, as i Qeverisë e as i FFK-së

"Stadiumi nuk është as i Qeverisë e as i Federatës. U takon qytetarëve të Prishtinës. Ne kemi nderin që aty të luajë Kosova drejt kualifikimit për kampionat dhe Prishtina lojërat kampionale, por askush nuk ka të drejtë as të ndajë lokale e as të vendosë ndeshje të tjera", ka thënë Shpend Ahmeti

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka reaguar ndaj vendimit të fundit të Federatës së Futbollit të Kosovës, që derbi në mes të Gjilanit dhe Dritës të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Ahmeti ka thënë se stadiumi është i Prishtinës, e jo i Qeverisë dhe i FFK-së. "Stadiumi nuk është as i Qeverisë e as i Federatës. U takon qytetarëve të Prishtinës. Ne kemi nderin që aty të luajë Kosova drejt kualifikimit për kampionat dhe Prishtina lojërat kampionale, por askush nuk ka të drejtë as të ndajë lokale e as të vendosë ndeshje të tjera", ka thënë Ahmeti, i cili ka treguar se që nga



renovimi i stadiumit Qeveria nuk e ka bërë pranimin teknik dhe si pasojë objekti i rinovuar nuk është dorëzuar te komuna. "Objekti ka filluar të ketë probleme ende pa u bërë pranimi. Për shkak të rëndësisë së ndeshjeve ndërkombëtare të Kosovës nuk kemi deklaruar asgjë në lidhje me këtë, por tani dikush ka filluar të ndajë lokale e zyra e Federata ka vendosur të luhen edhe ndeshjet e tjera kampi-

onale si Drita - Gjilani pa u konsultuar fare me komunën", ka shtuar Ahmeti.

Numri një i Komunës së Prishtinës ka kërkuar nga Ministria e Sportit që të bëjë sa më shpejt dorëzimin e stadiumit sipas marrëveshjes, përndryshe do t'i lirojnë hapësirat me ligjet në fuqi. "Kërkojmë nga ministria që sa më parë ta dorëzojë stadiumin sipas marrëveshjes dhe, po ashtu, që çdo vendim për lokale e lojë të bëhet me bazë ligjore, përndryshe jemi të detyruar t'i lirojmë hapësirat me ligjet në fuqi. Ne kemi mirëkuptim, por çdo gjë duhet të bëhet me ligj dhe në përputhje me interesin publik", ka shtuar Ahmeti.



Qeveria ndan 500 mijë euro për Përfaqësuesen e Kosovës

PRISHTINË, 2 PRILL - Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur sot, ka miratuar vendimin për ndarjen e 500 mijë euro për Përfaqësuesen e Kosovës në futboll. "Qeveria e Kosovës ka miratuar në mbledhjen e sotme vendimin, sipas të cilit, ka ndarë 500 mijë euro për Kombëtaren e Kosovës në Futboll", thuhet në njoftimin e Qeverisë. Kjo shumë u është ndarë futbollistëve të Kosovës pas suksesit historik të arritur në Ligën e Kombeve.

Muslija, afër t'u bashkohet "Dardanëve"

PRISHTINË, 2 PRILL - Drejtuesit e Kosovës vazhdojnë "gjetinën" e talenteve që janë duke spikatur në Evropë. Një tjetër futbollist mund t'u bashkohet dardanëve

për 2 ndeshjet e muajit qershor ndaj Malit të Zi dhe Bullgarisë të vlefshme për kualifikueset e "Euro 2020". Bëhet fjalë për talentin e Hannoverit, Florent

Muslija. 20-vjeçari numëron 13 paraqitje këtë sezon me fanelën e Hannoverit në Bundesligën gjermane, teksa ka arritur të gjejë edhe dy herë

rrugën e rretës. Mësohet se Muslija ka darkuar ditët e fundit me përfaqësuesin e Federatës së Futbollit të Kosovës për Gjermaninë, Fekmi Kongjeli, si

dhe sulmuesin e Shpresave të Shqipërisë, Valdrin Mustafa, në një restorant në Gjermani. Gjasat janë të mëdha që Muslija ta vesh fanelën e Kosovës.

Mourinho: Më pëlqen të punoj në Gjermani

MÜNCHEN, 2 PRILL - Trajneri Jose Mourinho nuk e ka përjashtuar mundësinë që ta marrë drejtimin e Bayern Munchenit. Ish-trajneri i Chelsea, Real Madridit, Interit

dhe Manchester Unitedit, ka thënë se do t'i pëlqente të drejtojë një klub në Gjermani. "Unë nuk e kam drejtuar asnjëherë ndonjë klub në Gjermani, kështu

që pse jo? Do ta shohim. Do të më pëlqente ta provoja ta fitoj për herë të tretë titullin e Ligës së Kampionëve me një klub të tretë dhe ta fitoj titullin e ligës për herë

të pestë në ndonjë vend tjetër. Por, unë nuk e arrij gjithmonë atë që dua dhe ambiciet e mia janë të kufizuara nga kjo gjë", ka thënë Mourinho.



Gnabry dhe Witseli ndezin klasiken Bayern - Dortmund

MÜNCHEN, 2 PRILL - Bundesliga gjithnjë premtan për emocione të forta, por ende më e luftuar bëhet kur vjen momenti i klasikes gjermane të futbollit me dy prej gjigantëve si Bayern Munchen dhe Borussia Dortmund që do të sfidohen këtë të shtunë në "Alianz Arena". Gjithsesi këtë herë protagonistë të kësaj supersfide bëhen dy prej lojtarëve kryesorë të skuadrave respektive që në vigjilje të duelit japin opinionet e tyre në lidhje me të. Kështu mesfushori 23-vjeçar Serge Gnabry kërkon hakmarrjen ndaj verdhezinjve të Dortmundit me kampionët në fuqi të Gjermanisë që e shohin veten dy pikë poshtë Dortmundit në tabelën e klasifikimit. "E presim këtë takim me optimizëm të lartë sepse vërtetohet se kemi potencial të madh me ato nëntë pikë shkëputjeje që i kompensuam ndaj Dortmundit. Jemi besimplotë pasi verdhezinjtë kanë treguar se janë të thyeshëm në momente të caktuara, siç e kanë treguar duke rrëshqitur nga pozicioni i tyre disa herë gjatë këtij edicioni. Sidoqoftë, ky takim është i një rëndësie të madhe për të dyja këto ekipe ndaj ne do të zbresim në fushë më të motivuar se kurrë për të



qenë sërish kampionë dhe për ta çuar trofeun e radhës në shtëpi. Kjo ndeshje është mishërim i rivalitetit me Dortmundin që mbetet skuadra për t'u mundur në kampionatin gjerman. Kjo është ndeshja më e madhe e sezonit dhe jemi të lumtur që kemi avantazhin që e luajmë në shtëpi këtë herë", ka thënë Serge Gnabry, futbollist i Bayernit.

Nga ana tjetër qëndron belgu 30-vjeçar, Axel Witsel, që, gjithashtu, prezantohet shumë optimist në vigjilje të klasikes gjermane. "Aktualisht jemi liderët e kampionatit dhe nuk duam të ndryshojmë asgjë nga kjo. Me këtë motivim do të shkojmë në Munchen dhe do të japim më të mirën tonë.

Dortmundi e pret prej shumë kohësh këtë titull dhe do ta bëjmë maksimumin për ta sjellë atë në shtëpi. Gjithsesi është e kotë të dalësh me deklarata kur fjalën tonë do ta themi në mënyrën më të mirë të mundshme në fushën e blertë. Sigurisht se parashikohet një ndeshje shumë e fortë dhe e luftuar, por tashmë që kemi mbërritur deri në këtë pikë, kërkojmë majën. Do të shkojmë në Munchen, me synimin e vetëm të tri pikëve të fitores. Në këtë fazë çdo ndeshje mund të konsiderohet si një finale, por mentaliteti është ai u duhuri në kampin tonë, ndaj do të luftojmë të marrim hap pas hapi të gjitha fitoret që kërkojmë", ka deklaruar Witsel.

Fitojnë Indiana dhe Bostoni

BOSTON, 2 PRILL - U luajtën nëntë ndeshjet e radhës në NBA, kampionatin më të fortë të basketbollit në botë. Indiana Pacersi dhe Boston Celticsi kanë triumfuar sërish në prag të fillimit të "play-off"-it. Të parët mposhtën Detroit Pistonsin me rezultatin 111-102, ndërsa "keltët" kaluan me sukses Miami Heatin. Rezultati përfundimtar në këtë përplasje ishte 110-105. "Paqësorët" e kanë siguruar vendin në "play-off", ndërsa Pistonsi duhet t'i luajë edhe disa ndeshje që të kualifikohet për në fazën përfundimtare të NBA-së. Edhe Indiana matematikisht e ka siguruar vendin në "play-off". Pranë këtij "stacioni" të garës duket edhe Detroiti.



REZULTATET

Boston Celtic - Miami Heat	110-105
Brooklyn - Milwaukee	121-131
New York - Chicago	113-105
Toronto - Orlando	121-109
Minnesota - Portland	122-132
Dallas - Philadelphia	122-102
Utah - Charlotte	111-102
Phoenix - Cleveland	122-113
Indiana - Detroit	111-102

SHKURT

Pergjokaj, trajner i përkohshëm i Dukagjinit

Ndue Pergjokaj do të jetë trajner i Dukagjinit në ndeshjen që skuadra nga Klina e zhvillon të mërkurën ndaj Vllaznisë nga Pozharani. "Ekipin në ndeshjen që zhvillohet ndaj Vllaznisë (P) do ta drejtojë nga bankina si kryetrajner Ndue Pergjokaj së bashku me ndihmëstrajnerin Skënder Gashi", ka njoftuar skuadra e Dukagjinit.

Rashica, lojtari më i shtrenjtë i Bremenit

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Milot Rashica, është lojtari më i paguar i shtrenjtë i skuadrës së Werder Bremenit. Observatori i futbollit, i njohur me emrin CIES, ka publikuar përditësimin e fundit për vlerën e lojtarëve për pesë ligat më të forta në Evropë, kurse vlera e Rashicës është 12 milionë euro.

"France Football": Messi dhe Simeone, më të paguarit në futboll


Futbolli dhe financat janë gjithnjë e më të ndërthurura mes tyre. Paratë që qarkullojnë në këtë disiplinë sportive janë në shifra marramendëse, siç është rasti i pagesave të lojtarëve e trajnerëve. Revista prestigjioze "France Football" ka përpiluar një klasifikim të pesë futbollistëve dhe teknikëve më të paguar në botë, duke u bazuar te pagat që ata marrin nga klubet, shpërblimet dhe të ardhurat e tjera. Sipas kësaj reviste, futbollisti më i paguar në botë është Lionel Messi, me kapitenin e Barcelonës që përfiton 130 milionë euro, duke lënë pas në vendin e dytë rivalin e tij, Cristiano Ronaldo. Ylli portugez i Juventusit, që paguhet më shumë në krahasim me vitin e kaluar, përfiton 113 milionë euro, ndërkohë që podiumin e plotëson braziliani i Paris Saint-Germainit, Neymar, me 91.5 milionë euro, i ndjekur nga Antoine Griezmann dhe Gareth Bale. Sa iu përket trajnerëve, kampion në financa është ai i Atletico së Madridit, Diego Simeone, me 41 milionë euro. Pas tij qëndron Jose Mourinho, tashmë i shkarkuar nga Manchester Unitedi, me 31 milionë euro, ndërsa në vendin e tretë është një tjetër teknik i shkarkuar, Thierry Henry, i cili qëndroi vetëm tre muaj në stolin e Monacos, duke përfituar 25.5 milionë euro. Pas francezitet renditen Pep Guardiola i Manchester Cityt dhe Ernesto Valverde i Barcelonës.

Zidane kundër largimit të Varanes

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është kundër largimit të Raphael Varanes nga "Santiago Bernabeu". Trajneri francez e ka vlerësuar mbrojtësin si më të mirin në botë. "Nuk dua që ai të largohet. Askush nga ne nuk dëshiron që ai të largohet. Ai është ende i ri. Ai ka tetë vjet që është këtu me ne dhe po luan mirë. Ai nuk më ka thënë mua asgjë rreth largimit. Çfarë vendimi të marrin lojtarët, ata më tregojnë mua. Aktualisht ai është më i miri në botë", ka thënë Zidane.

Coutinho preferon kalimin te Chelsea para Unitedit

Barcelona dhe Philippe Coutinho kanë rënë dakord të ndahen në fund të sezonit. Mesfushori ka dështuar të përshtatet me sistemin e trajnerit të katalunasve, Ernesto Valverden, dhe ka pranuar se duhet bërë përpara në karrierë. E përditshmja sportive spanjolle "Sport" shkruan se braziliani i është thënë tashmë se duhet të gjejë një klub të ri, por ka dy kërkesa. Mesfushori dëshiron të sigurohet se do të luajë në pozitën e tij të preferuar dhe gjithashtu klubi në fjalë do të ketë nevojë për fuqinë e shpenzimeve për ta përmbushur vlerësimin e Barcelonës. Mediet raportojnë se blaugranat duan 130 milionë euro dhe tashmë janë në luftë PSG-ja, Manchester United dhe Chelsea. Ish-ylli i Liverpoolit do të preferonte të kalonte te Chelsea para Unitedit.



Drejtoria e Arsimit
05-NR. 326
Me datë 01.04.2019

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 5 (shkronja d) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 34 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Udhëzimit administrativ MASHT nr.08/2014 të dt.25.02.2014 për procedurat dhe kriterët e zgjedhjes së Drejtorit dhe zv.drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Drejtoria e Arsimit në Suharekë shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendeve të punës

Titulli i vendit të punës : Drejtor i shkollës së mesme të ulët (SHFMU)

1.SHFMU"Shkëndija"-Suharekë

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i pozitave : një (1) pozitë

Kategoria funksionale: Nivel drejtues

Koeficienti: 7.8

Kohëzgjatja e kontratës : katër(4) vite

Nr.referencës: RN00004575

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- > Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:
- > Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me nxënësit, mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- > Përdorimin efikas dhe efektiv të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës;
- > Kujdeset për sigurinë e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe harton planin e veprimtari për parandalimin e dhunës në shkollë
- > Monitorimin (hospitimin) e orëve mësimore me formular përkatës të monitorimit (procesverbal me rekomandime).
- > Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimin sipas kërkesave të KDSH-së dhe detyrat lidhura me kurrikulimin.
- > Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga Komuna apo Ministria.
- > Mbajtjen e së paku 10 orëve mësimore në shkollat që kanë më pak se 250 nxënës dhe çështjet e tjera që rregullohen përmes Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, kryen punët tjera sipas urdhërësës së Drejtorit të DKA-së.

Kushtet: Kushtet dhe detyrat e punës sipas Udhëzimit Administrativ nga MASHT nr.08/2014 janë:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
2. Të kenë të kryer së paku Arsimin Universitar të nivelit themelor (së paku kualifikim prej 240 ECTS/ - 4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullat tjetër ligjore.
3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit
4. Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
5. Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucionet e arsimit,

Aplikacionit duhet të i bashkëngjiten këto dokumente:

- ✓ Certifikata e lindjes
- ✓ Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës
- ✓ Dëshminë për përvojën e punës
- ✓ Portfolion profesional (sipas shtojcës G të udhëzimit administrativ MASHT 08/2014)
- ✓ Letër referencë nga një institucion publik-kredibil si (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë).
- ✓ Letra e referencës duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- ✓ Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (sipas udhëzimit administrativ MASHT nr.23/2016).
- ✓ Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.
- ✓ Dëshmi se nuk është nën hetim.


Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentat e bashkëngjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet".

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse në Komunën e Suharekës.

Aplikacionet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk merren në shqyrtim nga komisioni Afati i konkurimit (15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bytyqi



Direkcija za obrazovanje
05 BR. 326
Datum: 01.04.2019

Na osnovu člana 11. stav 1., člana 18 stav 1 Zakona br 03 / L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova, člana 5 (slovo d) Zakona 03 / L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosova, člana 34. Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova 04 / L-032, Administrativnog uputstva MONT-a br.08 / 2014 dt.25.02.2014 o procedurama i kriterijumima za izbor direktora i zamenika direktora obrazovno-vaspitne institucije, Direktor Obrazovanja u Suvoj Reci objavljuje:

KONKURS Za popunjavanje slobodnih radnih mesta

Radno mesto: Direktor srednje niže škole (SNS)

1.SNŠ "Shkendija" – Suvareka

Vrsta radnog mesta: na određeno vreme, puno radno vreme

Broj pozicija: jedna (1) pozicija

Funkcionalna kategorija: Rukovodeći nivo

Koeficijent: 7.8

Trajanje ugovora: četiri (4) godine

Referentni broj: RB00004575

Dužnosti i odgovornosti:

- > Direktor obrazovne institucije ima izvršne odgovornosti u celokupnom menadžmentu i administraciji institucije, uključujući:
- > Dužnosti za izbor, ocenjivanje, disciplinu i druga pitanja koja se odnose na učenike, nastavnike i druge obrazovne radnike;
- > Efikasno i delotvorno korišćenje informacija o upravljanju obrazovanjem i poštovanje povezanih kodova prakse;
- > Stara se o sigurnosti učenika i nastavnika i izrađuje akcioni plan za prevenciju nasilja u školi
- > Procenje (hospitacija) časova nastave sa odgovarajućim monitoringom (zapisnik sa preporukama).
- > Planiranje i upravljanje školskim budžetom u skladu sa zahtevima KDS i nastavni plan i program
- > Čuvanje dokumenata i podataka, kako to predviđa Opština ili Ministarstvo.
- > Održavanje najmanje 10 časova nastave u školama koje imaju manje od 250 učenika i druga pitanja koja su regulisana Zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova, Obavlja druge poslove po naređenju Direkcije ODO

Uslovi: Uslovi i obaveze prema Administrativnom uputstvu MONT-a br. 08/2014 su:

1. Da su državljani Republike Kosova.
2. Da su završili najmanje univerzitetsko obrazovanje osnovnog nivoa (najmanje kvalifikacija 240 ECTS// - 4 godine univerzitetskog obrazovanja), prihvatljivih profila za poziciju nastave

nastavnika prema Uredbi o licenciranju nastavnika i pravila o zapošljavanju nastavnog osoblja i drugih zakonskih propisa.

3. Da imaju urednu licencu nastavnika i oni koji su u postupku licenciranja
4. Da su uspešno završili jedan od akreditovanih programa stručnog usavršavanja za rukovodstvo administriranje ili upravljanje.
5. Da imaju najmanje 3 godine radnog iskustva u obrazovanju ili obrazovnim institucijama,

Aplikacija treba priložiti ove dokumente:

- * Izvod rođenja,
- * Diplomu završenog fakulteta za odgovarajući nivo
- * Dokaz o radnom iskustvu
- * Profesionalni portfolio (prema Dodatku G Administrativnog uputstva MONT-a br. 08/2014)
- * Referentno pismo od kredibilne javne institucije kao što je (Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, MONT, ODO, školski upravni odbor, prethodni poslodavac, ustanove visokog obrazovanja).
- * Referentno pismo treba da sadrži dokaze o prethodnom radu i angažovanju
- * Plan razvoja vaspitno-obrazovne institucije za koju je konkurisao (prema Administrativnom Uputstvu MONT-a br.23 / 2016).
- * Uverenje o zdravstvenom stanju izdate od strane javne zdravstvene institucije koje potvrđuje njegov/njen zdravstveni status.
- * Dokaz da nije pod istragom.

U aplikaciji treba jasno navesti naziv posla i priložena dokumentacija treba biti fotokopirana i ne vraća se. "Kosovska Civilna služba obezbeđuje jednake šanse za zaposlenje za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz svih zajednica."

Prijave se primaju i dostavljaju prijemnoj kancelariji u opštini Suva Reka.

Komisija ne razmatra nekompletne prijave i one koji dolaze nakon isteka roka

Rok za podnošenje aplikacije pisma (15) dana od dana objavljivanja oglasa u medijima.

Direktor ODO-a
Remzi Bytyqi



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Njësia e Personelit / Jedinica za Personal / Personnel Unit



01Nr./br.1069
Me dt./dana.02.04.2019.
Rahovec/Orahovac

Form. MAP- SHCK-02
Obraz. MJU-CSK-02

SHPALLJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucionij/ Komuna e Rahovecit / kërkon të punësoj në Drejtorinë për Arsim.
Institucija / Opština Orahovac želi da regrutuje u Direkcije za Obrazovanje.

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Zyrtaar/e për Arsimin e Mesëm të Ulët - (1 pozitë)
- Zvaničnik/ica za Niže Srednje Obrazovanje -(1 položaj)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: P2-G9/ koeficienti i pagës 7.
Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta: P2-G9/koeficijent plate 7.

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto: AR/520.

Detyrat dhe përgjegjësitë/ Poslovi i odgovornosti :

[Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore/(Ukratko i Tačno naznačite osnovne odgovornosti):

- planifikimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e procesit arsimor në institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët
- identifikimin e nevojave të institucioneve arsimore në komunë
- sigurimin e përfshirjes së fëmijëve në institucionet e arsimit
- mbledhjen e të dhënave për institucionet edukative të niveleve përkatëse
- propozimin e masave të ndryshme për avancimin e arsimit të përgjithshëm, profesional dhe special në komunë
- bashkëpunimin me organet komunale dhe ZRA me qëllim të kontrollit dhe vlerësimit të institucioneve përkatëse të arsimit
- paraqet raporte punë mujore, periodike dhe vjetore
- kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së cprorit që janë në pajtim me ligji
- vrši planiranjë svih aktivnosti koji se tiču odvijanja obrazovnog procesa u osnovnim i srednje nižem obrazovanju
- vrši identifikaciju potreba institucija obrazovanja u opštini
- obezbeđuje uključenje dece u institucijama obrazovanja
- prikupljanje podataka za institucije obrazovanja dotičnog nivoa
- predlaže mere za unapređenje opšteg, stručnog i specijalnog obrazovanja u opštini
- saraduje sa opštinskim organima i R.K.O u cilju kontrole i procene dotičnih institucija obrazovanja
- podnosi mesečne, periodične i godišnje izveštaj o radu
- vrši i druge dužnosti, a prema zahtevu starešine koje su u skladu sa zakonor

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

[Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil/Navedite uslove za učešće u procesu regrutacije po Zakonu o Javnoj Službi]

Kandidati përveç kushteve të lartë shënuar duhet ti plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149, si dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës,të mos jenë nën hetime penale apo i dënuar për vepër penale . Kandidat osim gorenavedenih uslova treba da ispuni i opšte uslove predviđene Zakonom o Civilnoj Službi br. 03/L-149, kao i Kosovskih zakona koji su u primeni , da nije pod krivičnom istragom ili kažnjen zbog krivičnog dela.

Procedurat e konkurrimit/ Postupak konkurisanja/

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civil ekzistues/Navedite ukoliko je procedura za konkurisanje javno objavljena i za javne službenike koji rade u instituciji ili je interna procedura za službenike koji već rade:

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues edhe për kandidatët e jashtëm .Postupak konkurisanja je otvoren kako za postojeće civilne službenike tako i za spoljne kandidate .

Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/Upišite realno potrebno obrazovanje za obavljanje ovog posla]

Përgatitja shkollore: Diplomë universitare- Fakulteti i Edukimit (profili arsimor), filozofi dhe sociologji.

Shkollësia sprema: Univerziteti diploma- Pedagoški Fakultet (obrazovni profil), filozofija i sociologija.
Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

- [Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat mundën me qenë të dëshiruara. Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive/Opišite sposobnosti, iskustvo i licne osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One treba da su u vezi sa radon i da su objektivne]:
- njohuri në fushën e arsimit
- njohuri të ligjeve dhe rregullore të aplikueshme
- shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ

- shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
- shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)
- minimum 2 vite përvojë pune
- poznavanje u oblast obrazovanja
- poznavanje sprovedljivih zakona i pravilnika
- sposobnost komunikacije, planiranja rada, eventualno rukovodenje osoblja na administrativnom nivou
- sposobnost istraživanja, analitike, procene i izrade preporuka i stručnih saveta
- sposobnosti računarski aplikacija programa (Word, Excel, Power Point, Access)
- minimum 2. godine radnog iskustva

Dokumentet që kërkohen:

- Diploma
- Diploma
- CV-ja
- CV
- Vërtetimi që nuk është nën hetime
- Potvrda da nije pod istragom
- Çertifikata e lindjes
- Izvod Rođenja
- Kopja e letërnjoftimit
- Kopija lične karte
- Dëshmi e përvojës së punës
- Dokaz o radnom iskustvu

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin/Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

[Shënoni një përshkrim të shkurtë të përzgjedhjes dhe të rregulloreve ekzistuese që rregullojnë rekrutimin / Navedite kratak opis izbora i postojećih pravilnika koji regulišu zapošljavanje] Kandidatët e sukseshëm do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Shërbyesve Civil dhe Rregulloren e Rekrutimit nr 02/2010. Uspešni kandidati uputiće se na pismenom testiranju i usmenom intervjuisanju. Izbor će se izvršiti na osnovu zakona o Civilnoj Službi i Pravilnika za Regrutaciju Br.02/2010.

Kohëzgjatja e emërimit/Vremenski rok imenovanja:

[Shënoni nëse emërimi është me kohë të caktuar ose me kohë të pacaktuar dhe periudhën e kohëzgjatjes/ Naznačite ako imenovanje je na određeno vreme ili na neodređeno vremenski rok]:

Në kohë të pacaktuar. Na neodređeno vreme.

Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa :

[Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes/Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok].

Afati i Konkursit është 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik. Rok za konkurisanje je 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja.

Paraqitja e kërkesave/Prijava zahteva-Podnošenje zahteva/

[Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues/Navedite kako i gde se mogu dobiti obrazci za konkurisanje i mesto gde može predati i tačna adresa institucije]

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e pranimit në objektin e Komunës së Rahovecit Adresa:Rruga, Xhelal Hajda-Toni" pn. Rahovec.Aplikacije se mogu podići i dostaviti pri prijemoj kancelariji u objektu Opština Orahovac.Adresa: Ul." Xhelal Hajda-Toni" b.b Orahovac.

Kërkesat specifike / Specifični zahtevi

[Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës, përfshirë kërkesën për vlerësim mjekësor/Navedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizike prirode za izvršavanje radnih obaveza, sa zahtevom za mišljenje lekara].

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/Kosovska javnana služba je u službi svih ljudi na Kosovu, i prima aplikacije muškaraca i žena iz svih Kosovskih zajednica

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

-Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljani proporcionalno u organima Javne službe na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno i Čl. 11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Primljeni zahtevi nakon zatvaranja konkursa neće biti prihvacene. Nekompletirani zahtevi biće odbijeni.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen/Usled velikog broja primljenih zahteva, bice pozvani samo kandidati koji su usli u uzi izbor.

Shënoni emri dhe mbiemri, numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Napišite ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica:

Ymret Reshiti, Udhëheqës i Personelit tel:044/203-914.

Ymret Reshiti, Rukovodilac Osoblja, tel. 044/203-914.

Udhëheqësi i Personelit
Rukovodilac Osoblja
Ymret Reshiti



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES
AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

I

Titulli i punës: Vozites

Institucioni: MKRS

Kategoria funksionale : Koeficienti: 6

Numri i referencës: 21/2019

I përgjegjjet: Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji të Informacionit dhe Shërbimeve Logjistike

Vendi: Prishtinë

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (Kohëzgjatja 6 muaj).

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji të Informacionit dhe Shërbimeve Logjistike, përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

1. Ofron transport sipas nevojave të stafit të administratës së MKRS-së;
2. Sipas nevojës, ofron transport për të ftuarit e Ministrisë;
3. Bënë kontrollimin elementar teknik në mënyrë të kohëpaskohshme, të veturave të Ministrisë;
4. Shpërndan dokumentet nga MKRS në institucione tjera;
5. Kujdeset për mirëmbajtjen e veturave dhe pastërtinë e tyre;
6. Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të logjistikës.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplome e Shkollimit të Mesëm;
2. Së paku 1 (një) vit, përvojë pune;
3. Aftësi të mjaftueshme që herë pas here, të merret me disa çështje, të cilat nuk janë parapare në udhëzime, por që lidhen me nevojat e institucionit;
4. Aftësi të mira komunikuese, me punonjësit tjerë të njëjtit nivel, në njësinë organizative brenda institucionit, ose me persona të tjerë, me qëllim të shkëmbimit të informatave;
5. Të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërmjetore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesë (5) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 07.04.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereza" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449, (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org>).



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES
AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazirajući se na Zakon o Civilnim Uslugama Republike Kosova, Z. br. 03/L-149, Pravilnik br. 02/2010, o Procedurama za Rekrutovanje u Civilnim Uslugama Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

I

Naziv rada: Šofer

Institucioni: MKOS

Funkcionalna kategorija : Koeficientat: 6

Numri i referencës: 21/2019

Odgovorani je: Rukovodioc za Tehnicku Informaciju i Logistickih Usluga

Mesto: Pristina

Vrsta ugovora: Sporazum o posebnim Uslugama (Vremensko trajanje 6 meseci).

Zadaci i odgovornosti: Po nadzorom Rukovodioca za Tehnicku Informaciju i Logistickih Usluga, ispunjava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Nudi transport prema potrebama stafa i administracije MKOS-sa;
2. Prema potrebi, nudi transport za pozvane u Ministarstvu;
3. Vršiti elementarnu tehničku kontrolu, s vremena na vreme za vozila Ministarstva;
4. Raspedeljuje dokumenta iz MKOS-a u ostale institucije;
